



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:075053

Datë: 05.07.2019

Numri i dokumentit: 00394642

P.nr.141/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurve M..L.. dhe B...A... që të dy nga Gj..., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.138/2019, të datës 05.02.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 27.06.2019, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri M... L..., nga babai A... dhe nëna A..., e lindur K..., i lindur me datë ...në fshatin P... Komuna e Gj..., ndërsa me vendbanim në ...ka të kryer tri vite të shkollën fillore, i martuar, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe

E pandehura B... A..., nga babai R... dhe nëna D..., e lindur me datë ...në fshatin L... i E... Komuna e Gj..., ndërsa me vendbanim në Gj... ..ka të kryer shkollën fillore, e martuar, e papunë, e gjendjes së varfër ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës,

JANË FAJTORE

Sepse me datë 16.01.2019 rreth orës 20:10 minuta në Gj... në lagjen “...” në oborrin e shtëpisë së të pandehurve M... L... dhe B... A..., të pandehurit në bashkëveprim, me dashje dhe me qëllim të dëmtimit të integritetit trupor vëllait- kunatit, tani të dëmtuarit H... L..., kanë shkaktuar dhunë në familje duke përdorur forcën fizike me mjete të përshtatshme për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore-drunjë, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje fillimisht verbale në mes të pandehurit M.... dhe të dëmtuarit H.... lidhur me shitblerjen e një telefoni dhe pagesën për të njëjtin, vije deri tek konflikti fizik me ç ‘rast pas një fjalosje me fyerje e sharje të dyanshme, i pandehuri M..... tensionohet dhe e godet të dëmtuarin H.... me një dru në këmbën e majtë, me ç ‘rast ndërhyjnë edhe e pandehura Bedrije e cila po ashtu me një dru e godet të dëmtuarin dy herë në kokë, që për pasoj i dëmtuari rrëzohet për tokë pa ndjenja, ku si pasoj e goditjeve të dëmtuarit i shkaktojnë lëndime të lehta trupore sipas raportit mjekësorë nr.1232 të datës 16.01.2019 i lëshuar nga spitali i përgjithshëm në Gj...-Emergjencë, të cilat sipas ekspertizës mjeko-ligjore konstatohen lëndime të lehta trupore,

-Me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, lëndim të lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,41,42,49,50,51,52,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurve iu shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurvepër veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të pandehurit në periudhën verifikuese prej 2 (dy) viteve, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Obligohen të pandehurit që të paguajnë veç e veç paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 € (njëzetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 05.02.2019, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.138/2019, kundër tëqë të dy nga Gj....., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Më datë 27.06.2019, në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit, të pandehurit M... L... dhe B...A... si dhe i dëmtuari H...L..... Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, të pandehurit secili veç e veç kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen dhe se e pranojnë fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila ju vihet në barrë, me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPRK-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurve.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezent prokurorja e shtetit, të pandehuritsi dhe i dëmtuari....., dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurve për veprën penale për të cilën akuzohen ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPRK-së.Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se të pandehurit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmbanë aktakuza dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se të pandehuritkanë kryer veprën penale: lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se të pandehurve secilit veç e veç, duhet tu shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse të pandehurit nuk kryejnë vepra penale të njëjta apo vepër tjera penale në afat prej 2 (dy) viteve nga dita kur aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, ngase ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë parasysh faktin se të pandehuritqë të dy kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen në një fazë të hershme të procedurës penale, se për të dy të pandehurit e lartcekur është hera e parë që ata bien ndesh me ligjin, të njëjtit kanë premtuar se më nuk do të kryejnë vepra të tilla e as vepra të tjera penale, dhe se të pandehurit dhe i dëmtuari i kanë rregulluar raportet në mes vete dhe se më asnjëherë më nuk kanë pasur probleme të njëjtit, gjithashtu me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimeve gjykata mori parasysh edhe karakteristikat dhe sjelljen e mëparshme të pandehurve ku nga shkresat e lëndës shihet se për ta është hera e parë që bien ndesh me ligjin ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurit gjykata mori parasysh dashjen e tyre për shkaktimin e lëndimit trupor ku nga shkresat e lëndës shihet se të njëjtit në bashkveprim dhe me përdorimin e mjetit të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit trupor e kanë goditur të dëmtuarin të cilit ia kanë cënuar integritetin trupor duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore andaj gjykata konsideron se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6.Vendimi për kërkesën pasurore juridike.

Duke pasur parasysh deklarimin e të dëmtuarit, të bërë në seancën e shqyrtimi fillestar të datës 27.06.2019, se i njëjti nuk i bashkangjitet ndjekjes penale si dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike andaj gjykata nuk vendosi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurve, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurit veç e veç ti paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej nga 20 € (njëzet euro), në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.141/2019, me datë 27.06.2019

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.